REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATEN PUBLIKE

Ky projekt është financuar nga BE

departamenti dap Administratës Publike



# ECURIA E **REFORMËS**

Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike
Departamenti i Administratës Publike

Reforma në administratën publike në Shqipëri është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian (BE).



Reforma në administratën publike është në vijimësi ndër prioritetet e qeverisë shqiptare si një instrument kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit dhe si kusht për proceset integruese të vendit.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në 2009, Shqipëria është fokusuar në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimit të karrierës në shërbimin civil, trajnimin e vazhdueshëm, promovimin e etikës në administratën publike si dhe qeverisjen elektronike.

## Objektivat dhe Prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020 fokusohen në këto fusha:



Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit



Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike



Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore



Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

# KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor për shërbimin civil dhe ndërtimin e institucioneve është përmirësuar, mbështetur në:

#1

**Ligjin 90/2012** "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", i cili krijon një kuadër ligjor të njëjtë për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

#2

**Ligjin 152/2013** "Për nëpunësin civil", i cili krijon një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Ky ligj rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil.

#3

**Ligjin 10405/2011** "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", i cili përcakton organet që kanë kompetencë në këtë drejtim.

# REFORMA FUNKSIONAL-STRUKTURORE

Krijimi i strukturave efiçente dhe të përgjegjshme të administratës publike dhe uljen e korrupsionit.
Ndërtimi i një Administrate Publike që mundëson ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët dhe bizneset.

## RISHIKIMI FUNKSIONAL I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE



## QYTETARI NË QENDËR

#1

Eliminimi i mbivendosjeve

#2

Rishikimi i funksioneve, rolit dhe organizimit strukturor

#3

Bashkimi i institucioneve ose krijimi i institucioneve të reja

# BURIMET NJERËZORE



## HRMIS
## SISTEMI INFORMATIK I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- Ndërlidhja midis HRMIS dhe platformave të tjera
- Shtrirja e HRMIS në të gjitha institucionet
- Krijimi dhe verifikimi i dosjes personale për të gjithë punonjësit publik

# PËRSHKRIMI I PUNËS

## UDHËZIM PRAKTIK

Rregulla të përgjithshme (si të hartojmë një përshkrim pune)

Kompetencat dhe aftësitë

Ilustrim hap pas hapi

Hartimi i përshkrimeve standarde të punës me bashkëpunimin e Projektit të Binjakëzimit

## SHËMBULL I NJË PËRSHKRIMI PUNE



**SPECIALIST JURIST**
(përjashtohen nga ky grup specialistët e rrjetit të hartimit të legjislacionit)

**FUNKSIONET HORIZONTALE**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës**
***(qëllimi i ekzistencës dhe detyrat kryesore)***

Sigurimi i respektimit të kuadrit ligjor dhe cilësisë së hartimit të akteve juridike.
Më konkretisht:

- Jep këshillim juridik dhe ekspertizë në përpunimin e teksteve normative.
- Përfaqëson institucionin në grupet e punës të fushës juridike.
- Përfaqëson institucionin në çështje gjyqësore me të tretët.
- Jep mendim të specializuar lidhur me çështje të ndryshme ligjore të institucionit.
- Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe standardeve ligjore kur legjislacioni i fushës kërkon një gjë të tillë.
- Përditëson kuadrin ligjor me aktet normative më të fundit që i përkasin fushës së përgjegjësisë së institucionit dhe shpërndan këtë informacion brenda institucionit për zbatim. Në rastet kur në institucionet e varësisë së ministrive të linjës ka njësi juridike, këto institucione përditësojnë kuadrin ligjor brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

**Kërkesat e pranimit**

a. Në aparatin e Kryeministrisë, ministrive të linjës, institucionet e pavarura dhe institucionet qendrore të varësisë:

- Diplomë "Master Profesional" në shkenca juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor", duhet të jetë në shkenca juridike;
- 1 vit përvojë pune në profesion.

b. Në institucionet rajonale/vendore:

- Diplomë "Bachelor" në shkenca juridike.

| Fusha e Njohurive | Aftësitë dhe Cilësitë |
|---|---|
| • Kushtetuta<br>• Legjislacioni për procedurat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative<br>• Legjislacioni për rregullat etikes;<br>• Legjislacionin për nëpunësin civil dhe kodin e punës;<br>• Legjislacioni për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore | • Të zotërojë teknika të hartimit të tekstit ligjor<br>• Të bëjë analizë të kombinuar të hierarkisë së normave ligjore<br>• Të përshtatet me kompleksitetin e kuadrit ligjor |

# REKRUTIMI

## Konsolidimi i procesit të rekrutimit (Ligji nr. 152/ 2013)

- Thjeshtëzimi i procesit dhe rritja e transparencës
- Publikimi i materialeve orientuese (video udhëzuese)
- Panaire Pune (në bashkëpunim me universitetet)
- Zyrë mbështetëse për kandidatët

## Përmirësim i procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që aplikojnë për të qenë pjesë e Shërbimit Civil



Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të **Komiteteve të Përhershëm të Pranimit**



Përmirësimi i cilësisë së pyetjeve - **Banka e Pyetjeve**



Përmirësimi i **Intervistës**

## ECURIA E PROCESIT TË EMËRIMEVE PËR PERIUDHËN 2013-2016




## ECURIA NË KARRIERË




Ecuria e aplikimeve të suksesshme 2015-2016







Gjinia e kandidatëve

# TRAJNIMI

## Fuqizimi i kapaciteteve të ASPA-s është një objektiv strategjik për zbatimin e Reformës në Administratën Publike

Përmirësimi i kapaciteteve trajnuese të ASPA- s për trajnimin e **mbi 4000 nëpunësve civil** dhe realizimin e rreth **800 ditëve trajnimi.**

Realizimi i Trajnimit të thelluar për **TND** i cili përfshin 5 module trajnimi dhe **280 orë.**

Rritja e cilësisë së trajnimit duke siguruar që cilësia e kurrikulës të jetë sipas standardeve dhe **metodave inovative** të miratuara.

Fuqizimi i kapaciteteve në fushën e anti-korrupsionit dhe qeverisjes së mirë **përmes hartimit të kurrikulave** në fushën e arsimit, mjedisit, prokurimit publik për trajnimin e nëpunësve publikë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues.

Fuqizimi i kapaciteteve të administratës publike në nivel vendor përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese në përputhje me **nevojat për trajnim.**

## Grupi i synuar krahasues për 2014 - 2016




- Kategoria Ekzekutive
- Kategoria e ulët drejtuese
- Kategoria e mesme drejtuese
- TND

### Indikatorët për 2016

| VLERA: | INDIKATORËT: |
|---|---|
| 4640 | NËPUNËS CIVIL |
| 189 | KURSE TRAJNIMI |
| 726 | DITË TRAJNIMI |

# METODA INOVATIVE

*"Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efiçente."*



- PORTALI I REKRUTIMIT ONLINE
- HRMIS
- BANKA E PYETJEVE

# WEB SITE




# HRMIS



Projekti i Binjakëzimit "Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri" ofron mbështetje për Shqipërinë në përpjekjet e saj të vazhdueshme për ngritjen e një administrate publike moderne dhe efiçente, e aftë tu ofrojë shërbim me cilësi të lartë qytetarëve dhe vendimmarrësve.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është forcimi i mëtejshëm i sektorit publik dhe efiçencës së tij, përmes përmirësimit të procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe përafrimin e proceseve të Administratës Publike shqiptare me kriteret e Kopenhagës.

**Projekti zbatohet nga:**

Franca (partneri kryesor) përmes Shkollës Franceze të Administratës Publike (ENA)

Italia (partneri junior) përmes Shkollës Italiane të Administratës Publike (SNA)

Departamenti i Administratës Publike (DAP)

Ky projekt është financuar nga BE

## Projekti ka 3 komponentë:

- Zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil;
- Zbatimi i Kodit të Ri të Procedurave Administrative (KPA);
- Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit Civil.



ECURIA E
REFORMËS



WWW.DAP.GOV.AL

WWW.DAP.GOV.AL

facebook: DepartamentiAdministratesPublikeDAP
e-mail: info@dap.gov.al
website: www.dap.gov.al
twitter: @Departamenti

Ky publikim është ndërtuar me asistencën e Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e kësaj faqeje është përgjegjësi vetëm e partnerëve zbatues dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret sikur reflekton mendimet e Bashkimit Evropian.